



## **Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë Prezenca në Shqipëri**

**Fjalim i Ambasadorit Lipponen, Kryetar i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri,  
drejtuar Komisionit Amerikan për Sigurimin dhe Bashkëpunimin në Evropë,  
Uashington, 20 korrik 2004**

Ju faleminderit Z. Kryetar që më ftuat në këtë seancë për “Përparimin e Demokracisë në Shqipëri”. Ashtu siç e përmendet edhe ju, unë jam Kryetari i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri që prej dy vjetësh dhe do të largohem nga ky post në fund të shtatorit. Është një privilegj për mua që të jem këtu sot, sepse kjo më jep një mundësi për të përmbledhur para jush vlerësimin e Prezencës për arritjet e Shqipërisë gjatë viteve të fundit, si dhe sfidat e shumta me të cilat vendi po përballlet aktualisht.

Takimi i sotëm vjen në një moment kritik: ne jemi një vit larg zgjedhjeve të ardhshme parlamentare. Zhvillimi i këtyre zgjedhjeve duhet të përmbushë parashikimet tona të forta si brenda ashtu edhe jashtë vendit, ku këto zgjedhje shihen si një provë e rëndësishme e pjekurisë politike dhe zhvillimit demokratik të Shqipërisë. Pas bisedimeve të gjata të drejtuara nga Prezenca, Partia Socialiste, e cila ka shumicën qeverisëse, dhe Partia Demokratike e opozitës ranë më në fund dakort që të ngrinin një komision parlamentar *ad hoc* për të mbikëqyrur reformat e nevojshme zgjedhore të kërkuara nga ODIHR-i dhe Komisioni i Venecias i Këshillit të Evropës. Suksesi i këtij komisioni do të jetë vendimtar për krijimin e vullnetit politik të nevojshëm për zhvillimin e zgjedhjeve të ardhshme sipas standarteve ndërkombëtare. Ishte zhgënjyese që zgjedhjet vendore të tetorit të vitit të kaluar ishin një “mundësi e humbur” për plotësimin e këtyre standarteve.

Unë e di që raporti ynë është shpërndarë tashmë, kështu që, do të përqendrohem në theksimin e pikave më të rëndësishme.

Shqipëria është një vend që ka bërë përparime domethënëse që nga viti 1997, kur vendi përfundoi në një trazirë civile. Që nga ajo kohë, ka pasur një konsolidim të qëndrueshëm të shtetit dhe institucioneve të tij. Mandati i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, e vendosur për herë të parë në 1997-n për t'u përqendruar në fushat e demokratizimit, zgjedhjeve, të drejtave të njeriut dhe zhvillimit të medias, u ripërtëri kohët e fundit në mbarim të vitit të kaluar, me qëllim që të merrte në konsideratë përparimin e arritur në vend.

Arritjet e Shqipërisë janë njohur, gjithashtu, nga bashkësia ndërkombëtare përmes marrëdhënieve më të ngushta me NATO-n dhe një perspektive për anëtarësi të ardhshme, si dhe përmes hapjes së bisedimeve me Bashkimin Evropian mbi Marrëveshjen e Stabilizimit dhe Asociimit në janar 2003, hapi i parë ky drejt pranimit përfundimtar.

Megjithë përparimin e dukshëm, Shqipëria mbetet një vend me sfida të mëdha shoqërore dhe ekonomike, të cilat përbëjnë shkakun për një sërë problemesh që kanë

lidhje me to, duke filluar nga migrimi i paligjshëm dhe kontrabanda, deri tek korrupsioni galopant në administratën publike dhe sektorin ligjor.

Treguesit shoqërorë dhe ekonomikë të Shqipërisë janë të ulët: Produkti i Brendshëm Bruto për frymë prej rreth 1400 dollarësh është pothuajse më i ulëti në Evropë; 30% e popullsisë jeton nën nivelin e varfërisë. Shqipëria vuan nga një infrastrukturë e dobët dhe investime të pamjaftueshme në sektorët e shëndetësisë dhe arsimit. Ajo ka vuajtur, gjithashtu, nga një urbanizim shumë i shpejtë dhe lëvizje masive të popullsisë, të cilat vazhdojnë ende. Rritja ekonomike, megjithëse llogaritet mesatarisht rreth 6% në vit, kufizohet vetëm në një sektor të ngushtë ndërmarrjesh prodhuese, veçanërisht, në ndërtim, ku punësohet kryesisht një fuqi punëtore e pakualifikuar ose gjysmë e kualifikuar, me pothuajse asnjë lloj qëndrueshmërie afatgjatë. Procesi i privatizimit nuk ka mbaruar ende. Pjesa më e madhe e produkteve importohen duke shkaktuar një çekuilibër tregtar, që financohet kryesisht nga paratë e dërguara nga jashtë vendit, ku pothuajse çdo familje ka, të paktën, një të afërm në moshë pune.

Për këtë arsye, Shqipëria ka nevojë për politika të përqendruara dhe me objektiva të qarta për të zgjidhur këto probleme, që prekin në mënyrë të veçantë të varfërit e zonave rurale dhe të varfërit e paarsimuar të zonave urbane. Për shembull, nevojitet një ngushtim i ekonomisë gri, e nxitur nga kontrabanda dhe evazioni i taksave, për të rritur të ardhurat dhe për të financuar shërbime publike aq shumë të nevojshme.

Për fat të keq, pronësia e vërtetë në strategjitë kryesore të qeverisë është e kufizuar dhe duket se deklarohet vetëm për të kënaqur donatorët, në vend që të përdoret si mjet për zgjidhjen reale të problemeve. Për më tepër, duke pasur një sistem politik që ende nuk funksionon siç duhet, debati tenton të përqendrohet tek konflikti politik dhe jo të merret me gjetjen e mënyrave më të mira për të trajtuar çështje thelbësore, përfshirë të gjitha reformat e nevojshme për bisedimet me Bashkimin Evropian. Kjo situatë jashtëzakonisht e polarizuar politike, ku ekziston një shkallë e lartë mosbesimi dhe konflikti midis Partisë Socialiste dhe Partisë Demokratike, ka ndikuar negativisht në vend që nga rënia e komunizmit në vitin 1991. Përçarjet po e dëmtojnë rëndë mundësinë e Shqipërisë për t'u zhvilluar si një shtet evropian plotësisht demokratik dhe fërkimet e kohëve të fundit midis dy partive tregojnë se afrimi i integritetit në strukturat euro-atlantike nuk e ka ndryshuar këtë polarizim.

Për këtë, Shqipëria duhet të shkojë drejt një sistemi parlamentar që funksionon normalisht, duke filluar me zgjedhje të pakundërshtueshme të zhvilluara në përputhje me standartet ndërkombëtare, dhe një administratë publike që funksionon në mënyrë transparente, në mënyrë që të jetë në gjendje të menaxhojë problemet e rëndësishme shoqërore ekonomike dhe ato që lidhen me shtetin e së drejtës. Kjo duhet të mbështetet nga zgjerimi i pjesëmarrjes qytetare në procesin e qeverisjes, pasi korrupsioni dhe mungesa e përgjegjshmërisë e kanë dëmtuar rëndë besimin e publikut tek autoritetet e vendit.

Ka pasur disa shenja pozitive që shoqëria civile po lind dhe po fillon të ketë ndikim, megjithëse ende të kufizuar, mbi vendimet e politikave publike dhe në bërjen e qeverisë më të përgjegjshme. Ata kanë treguar, gjithashtu, shenja ndikimi edhe tek opozita.

Megjithatë, ekziston një tendencë shqetësuese e një ndërthurjeje të interesave politike me ato komerciale, që, ndonjëherë, përfshin edhe ekonominë e paligjshme, që ka mundësinë reale të ngadalësojnë kursin e zhvillimit të demokracisë në Shqipëri, duke e nënshtruar median ndaj ndërhyrjeve politike dhe duke dëmtuar shtetin ligjor. Cështjet e konfliktit të interesave shpërfillen gjerësisht, dhe, me sistemin aktual të kontroleve të pakta të financimit të partive, situata ku zgjedhjet ose kandidatët mund të blihen, vetëm mund të përkeqësohet. Për aq sa shoqëria civile mund të jetë duke u përpjekur të ushtrojë ndikimin e saj mbi qeverisjen e vendit, këto ndikime të tjera më të fuqishme, të shoqëruara nga një mbështetje e fortë financiare, po bëjnë të pamundurën që vendimmarrja të mbetet e mbyllur, e papërgjegjshme dhe jo transparente.

Disa vlerësime mbi rolin dhe domethënien e ekonomisë së paligjshme në Shqipëri thonë se ajo përbën deri në 1/3 e ekonomisë. Ky shihet si një vlerësim shumë konservativ. Raporte të kohëve të fundit tregojnë se vëllimi në para, i fituar nga trafikimi, vazhdon të rritet, ndërkohë që përpjekjet kundër trafikimit të qenieve njerëzore shkatërruan disa prej këtyre rrjeteve. Në vend të tij, tashmë është rritur trafikimi i narkotikëve, duke e bërë Shqipërinë një pikë tranziti shumë të rëndësishme për heroinën që vjen nga Afganistani nëpërmjet Turqisë.

I parë si një kërcënim i madh në rritje për vendin, krimi i organizuar, për më tepër, ka përfitur nga këto dobësi të vazhdueshme institucionale dhe ka shtuar vazhdimisht ndikimin e vet. Gjithashtu, pretendohet se ai po depërton edhe në sistemin politik. Kërcënimi nga krimi i organizuar, i lidhur me trafikimin në rritje të narkotikëve nëpërmjet Shqipërisë, nuk ndikon vetëm mbi Shqipërinë, por edhe mbi rajonin dhe Evropën në përgjithësi.

Shqipëria, pavarësisht nga realitetet e ashpra që ju paraqita sot, ka, sigurisht, një mundësi për përmirësim, por vetëm me kusht që njerëzit të rifitojnë besimin e tyre tek sistemi politik dhe, bashkë me të, edhe shpresën për ndryshim pozitiv. Kjo mund të arrihet me shoqërinë civile që po lind, dhe, veçanërisht, kur diaspora e fortë i ka qëndruar besnike promovimit të zhvillimit të mëtejshëm të vendit. Fatkeqësisht, kur diaspora vazhdon të rritet, edhe “rrjedhja e trurit” rritet bashkë me të. Kjo është vendimtare, veçanërisht, në ngritjen e një administrate publike që funksionon mirë.

Mbështetja ndërkombëtare për Shqipërinë do të jetë kyçe edhe për disa vjet të tjerë. Prezenca e OSBE-së në Shqipëri ka rolin e saj konstruktiv në proces si i vetmi aktor ndërkombëtar, që, deri tani, ka dhënë asistencë dhe mbështetje për ndërtimin e konsensusit, si një mjet ndërmjetësimi në situatën e polarizuar. Ky rol do të jetë i nevojshëm përsëri në të ardhmen, të paktën, deri në zgjedhje. Për më tepër, do të ketë nevojë për përvojën dhe shërbimet tona për ndërtimin e institucioneve dhe demokratizimin për, të paktën, edhe disa vjet të tjerë.

Shqipëria, me burimet e saj të kufizuara dhe sfidat e mëdha politike, sociale dhe ekonomike, do të ketë nevojë për të gjithë ndihmën që mund të marrë nga bashkësia ndërkombëtare. Prezenca e OSBE-së në Shqipëri nuk është një stigmë për vendin, por duhet parë si një aset pozitiv për zhvillimin e saj.

Do ta mbyll këtu me një fjalë të fundit mbi situatën parazgjedhore: komisioni i ri *ad hoc* për reformën zgjedhore është ngritur dhe do të fillojë nga puna. Grupi i

Ekspertëve Teknikë, i kryesuar nga Prezenca dhe që punon nën Komisionin, do të ketë nesër takimin e tij të parë të rëndësishëm. Ai ka një kornizë kohore shumë të ngjeshur, gjatë së cilës duhet të hartohen dhe pranohen të gjitha ndryshimet në Kodin Zgjedhor deri në fund të shtatorit për miratim nga Kuvendi. Ndryshimet mbi disa çështje, si përmirësimi i listave të zgjedhësve dhe kriteret për vendosjen e kufijve të zonave zgjedhore duhen miratuar edhe më shpejt për të lënë kohë të mjaftueshme përgatitore. Për këto çështje shumë politike, duke përfshirë KQZ-në, partitë politike, duhet të tregojnë vullnet politik maksimal për kompromis dhe për t'iu përmbajtur marrëveshjeve të tyre. Në rast të mungesës së vullnetit politik, zgjedhjet e ardhshme do të jenë një kthim mbrapa për Shqipërinë në zhvillimin e saj demokratik.